

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirë se erdhët në mbledhjen e muajit tetor data 22.10.2025. Pjesëmarrja është e konsiderueshme, mbledhjen e konsideroj të hapur. Bëjmë apelin edhe në formë elektronike por edhe me emra. Live është te faqja e bashkisë.

Enerieta Ferra – Zv. Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin. Në sallë janë 38 Antarë të Këshillit Bashkiak.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kalojmë tek pika e parë për miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, 1 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti kryetar kam një kërkesë në emër të komisionit të financës për efekte emergjente dua të shtojmë një pikë të rendit të ditës që është Menaxhimi I Integruar I rasteve (ICM) për punëkërkuesit e cënueshëm duke mbështetur rrugët e tyre nga ndihma sociale në punësim. Është një projekt I UNPD-së sipas programit të Bashkimit Europian që është marrë përsipër nga Tjetër Vizion dhe kërkohet me shumë emergjencë të miratohet. Është një projekt vendim që I vjen në ndihmë familjeve në nevojë, grave, vajzave. Duhet të miratohet që ti hapim rrugë aplikimit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Për të qenë në rregull me këshilltarët çdo projekt-vendim që sillet në mbledhje këshilli duhet të jetë 5 ditë përpara por në rast emergjence që I vjen në ndihmë mirëqënies së njerëzve me miratim të komisionit përkatës neni 77 I rregullores pika 5 na lejon që ne ta hedhim në votim dhe ta shtojmë tek rendi I ditës pra kjo shtohet tek procesverbali I rendit të ditës. Kush është pro që ta fusim në rend dite pastaj kur të vijë votimi e shpjegojmë një për një. Do ta bëjmë votimin me dorë.

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, 2 kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Muzhaqi: E. Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Procesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 2 e rendit të ditës

2. Miratimi I proçesverbalit të muajit shtator datë 01.10.2025

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro,- kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.
(A.Domni;A.Fetah;A.Kana;A.Murati;)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 3 e rendit të ditës

3. Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Z. Arbër Haxhiu

Luiza Popja-Anëtare e Këshillit Bashkiak

I nderuar Kryetar, të nderuar kolegë këshilltarë, komisioni I mandateve shqyrtoi dokumentacionin për dhënien e mandatit Z. Arbër Agron Haxhiu. Kjo vlen si rezultat i dorëheqjes së këshilltarit Z. Luan Rama i cili dha dorëheqjen me kërkesën e tij dhe pas deklarimit të mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit Z. Luan Rama, Këshilli Bashkiak ka njoftuar komisionin qendror të zgjedhjeve për krijimin e vakancës dhe komisioni qendror i zgjedhjeve pas kryerjes së procedurave përkatëse ka marrë vendim nr 13 /96 datë 09.10.2025 për plotësimin e vakancës me kandidat Z. Arbër Agron Haxhiu si kandidat i rradhës nga lista shumë emërore e subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë. Ky vendim i është përcjellë Këshillit Bashkiak me shkresën përkatëse datë 11.10.2025 për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit. Për sa më sipër bazuar në ligjin për qeverisjen vendore komisioni I mandateve i propozon Këshillit Bashkiak votimin për dhënien e mandatit Z. Arbër Agron Haxhiu. Faleminderit!

Këshilli Bashkiak me 39 vota pro,- kundër, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Domni)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Arbër mund të çohesh në këmbë. Betimi: Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegjie detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do ti bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetësave të Bashkisë Elbasan dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin e mirëqenien së tyre.

Arbër Haxhiu-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Betohem

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit dhe punë të mbarë bashkarisht

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4 e rendit të ditës

4. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I Bashkisë për Muajin Shtator 2025

Këshilli Bashkiak me 40 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj; E. Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 4.1 e rendit të ditës

4.1 Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për Muajin Shtator 2025

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj;E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 5 e rendit të ditës

5. Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1 Z.K 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan nga Bashkia Elbasan.

Shefqet Bullari-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ky projekt-vendim u pa dhe njëherë në komisionin e financës dhe përfaqësuesi i opozitës bëri 2 shtesa, një pikë shënohet që të mos ndryshojë destinacioni i objektit nga Akademia e Futbollit Elbasan dhe e dyta të shoqërohet draft-kontrata që do të lidhet midis palëve e cila është në dosje dhe të dyja pikat që tha nënkryetari u realizuan dhe unë mendoj që të votohet sepse është domosdoshmërisht që ekipi i futbollit ta ketë këtë godinë për sportistët cilësorë, për aktivitete kombëtare e ndërkombëtare etj etj

Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Zoti Lala e para është pozitive që reflektoheni ndonjëherë ndaj kërkesave, të cilat pjesën më të madhe të rasteve janë llogjike dhe ligjore. Si jurist shikoj këtë draft kontratën e më duket si draft kontratë e bërë sa për thënë. Sporti i çfarë do lloji disipline në Elbasan ka nevojë për mbështetje. Padyshim dhe për pjesën e AF-së, mbështetja sduhet të mungojë. Mirëpo duke qenë se Bashkia është aksioner tek AF-ja, natyrisht që rritet disa herë përgjegjësia dhe nuk e di a mjafton që në akt marrvëshjen që ka çdo SH.A, biznes me aksione në rastin konkret. A mjafton apo jo dhënia e servituteve si puna e kësaj pa kundërshtpërblim duke mos realizuar në thelb dhe bërthamë vetdetyrimet kontraktore që ka një SH.A. Përtej AF-së në Elbasan, sporti ndër vite është i vetmi profil që kemi që na ka bërë krenar ndonjëherë. Po unë do të sjell këtu rastin jo vetëm si kjo e AF-së që mungon mbështetja po ke dhe raste

psh si të një djali që ka Off Road Elbasan që sjell qindra mjete dhe nuk është financuar kurrë. Ka bërë aktivitete nga 5 milion lekë të vjetra duke impaktuar zona me nga 6 fshatra të Elbasanit deri në Gjinar, nga Elbasani deri në Funar, dhe kanë marrë zero mbështetje. Ndërkohë që I jepet AF-së nga Bashkia Elbasan si një aksionere në SH.A, një objekt I cili në vetvete te kjo kontrata edhe pse pa dëmshpërblim duhet të kishte një referencë që po miratoni dhe kto kushtet e qerasë, të kishte një referencë sa është kontributi real. Jeni aksionerë këtë sduhet ta harroni. Dhe nuk mjafton ti japësh një objekt AF-së ndërkohë që AF-ja ankohet nga mëngjesi deri në darkë për mungesën e suportit nga Bashkia Elbasan. Për sa kohë një nga aksionerët ose aksioneri mazhoritar I kësaj SH.A-je ankohet, unë mendoj që përgjegjësia si përfituesi më I madh I rezultateve të AF-së që është Bashkia Elbasan, duhet të jetë shumë herë më transparent dhe shumë herë më mbështetës. Unë gëzohem që reflektoni dhe bëni letra sa për të larë gojën si puna e kësaj draft-kontratës dhe uroj rezultate të mira AF-së si një asset I cili na bën krenar ndërkohë që duhet të ishte Bashkia Elbasan ajo që ti bënte krenar qytetarët e vet.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqenëse kjo është një pikë që e diskutuam herën tjetër në mbledhjen që kaloi, nuk e di ka njeri tjetër gjë?

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo çështja e sporteve është një çështje shumë e mprehtë. Sepse nga njëra anë ne kemi sporte që kanë popullaritet dhe nga ana tjetër në Elbasan ne kemi disa sporte të cilët me të vërtetë kanë arritur suksese të rëndësishme jo vetëm në nivel kombëtar por edhe nivel ndërkombëtar. Jam shumë dakort që ne ti trajtojmë madje në mënyrë të posaçme, çështjen e mbështetjes së sporteve në Bashkinë tone. Normal që futboli është ai më popullori, edhe pse kolegu e sqaroi shumë mirë nga ana ligjore, jam për atë që duhet ti trajtojmë më me vëmendje dhe në momentin që ka të bëjë me çështje financiare duhet të jemi Akoma më të vëmendshëm. Ne si linjë zyrtare e bashkisë e dogjëm një klub e ngritëm një tjetër. Nuk duhet ta djegim edhe këtë tjetrin. Kemi qenë neglizhent për disa evenimente të rëndësishme psh ne na ka ikur nja nga sportistët më në zë dhe më premtues sot, kampionia e Europës në peshëngritje, na I ka marrë Teuta, nuk e kemi mbështetur dot. Dhe tani po bëjmë procedurat ti japim pa lekë këtë këtyre

pastaj ti japim me lekë atyre, unë mendoj që duhet ti trajtojmë shumë më tepër vëmendje e përkushtim dhe me resurse konkrete. Resurset nuk mund të bëhen duke dhënë ambjente pa lekë. Të gjithë klubet që vijnë paguajnë, sportistët paguajnë, pse mos paguajnë ato që do vijnë tek ne? Kështu që unë jam parimisht dhe teknikisht kundër kësaj pike që ne të vazhdojmë të japim asete se nuk është kjo mbështetja. Sot sporti është biznes, biznesi do lekë edhe ne duhet ta perceptojmë sit ë tillë. Mbështetja nuk është thjesht duke dhënë disa ambjente pa lekë e pastaj nuk e dimë se çfarë bëjnë ato me ato ambjente. Po shpjegoj votën time kundër dhe qëndrimin tim që duhet të jemi shumë më të vëmendshëm në mbështetjen e sportistëve. Nuk ja fal dot bashkisë që na ka ikur ajo sportistja peshëngritësja që na I ka marrë Teuta.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit. Hapim votimin.

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, 3 kundër, 5 abstenim, miraton sa më sipër.

(A. Domni; E. Murataj; E. Muzhaqi)

(Y. Balliu; B. Çopja; A. Kana; A. Meçja; R. Mita)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 6 e rendit të ditës

6. Mbi shfuqëzimin e Vendimit Nr.79 dt.30.07.2024 dhe kalimin në varësi e administrim të ambjenteve të stadiumit “Elbasan Arena” Agjencise se Sherbimeve Publike Rurale (strukture vartese e Bashkise Elbasan).

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo ishte një pikë që ne e diskutuam herën e parë dhe e lamë për ta diskutuar.

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo pikë u referua dhe në mbledhjen e kaluar dhe nuk e di pse mbeti. Për mendimin e bashkisë është e domosdoshme që Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale disponon llogjistikë të mjaftueshme, mjete, fuqi punëtore që është e gatshme ta mirmbajnë stadiumin në ato parametra që kërkon federata e futbollit dhe nuk ka asnjë të keqe këtu për të thënë jo fshati jo qyteti. Kjo ka kapacitetet e duhura për ta mirëmbajtur këtë stadium dhe është e nevojshme të bëhet ky transferim.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Në fakt edhe terrenet sportive që kemi të sportit të vjetër për shkak të numrit në këtu nuk po rrisim po marrim një aset pa rritur numrin e punëtorëve dhe duke qenë se ndërmarrja publike e qytetit ka një numër më të kufizuar se ndërmarrja publike e zonave rurale. Ajo ka më shumë mjete, kapacitete njerëzore dhe pjesën e agronomëve të cilët merren me bujqësinë. Është patjetër më e domosdoshme dhe më efikase që dhe terrenet sportive ashtu siç I kemi te sporti I vjetër që kanë kaluar dhe po mirmbahen nga ASHPR-ja, edhe stadiumi I Elbasanit të vazhdojë të mirmbahet nga ASHPR-ja. Deri tani e kishte mirmbajtur ekipi I futbollit Elbasani dhe ne në paketë fiskale e kemi të rregulluar sistemin e funksionimit të stadiumit

vetë, për ato që vijnë lozin nga jashtë apo për ekipin tonë I cili loz pa pagesë. Është vetëm pjesa e mirmbajtjes dhe duke qenë se nuk rrisim dot dhe nuk rriten dot vetëm numrat për të mirmbajtur terrenet sportive pastjetër do ti mirmbajmë me agjencinë tonë të ndërmarrjes së punëve publike.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në fakt unë nuk e di sa I shërben kjo parullës ta bëjmë fshatin si qyteti por unë mendoj që ASHPR-ja ka mjaftueshëm barrë mbi kurriz përse I përket problematikës shumë të madhe që kanë zonat rurale të Elbasanit. Dhe përpara se ASHPR-ja të merret me fushën e sportit e përpara se ASHPR-ja të kujdeset për tapet bari, unë mendoj që duhen shtruar rrugët e fshatrave sepse kemi dimrin para dhe fëmijët duhet të shkojnë në shkollë dhe mësuesit duhet të japin mësim. Meqë I hoqëm nja 3 milion lekë barrë mujore AF-së me konviktin, nuk besoj që do të ishte ndonjë problem I madh që ta mirmbante atë fushën vetë dukë I dhënë qoftë edhe ndonjë shpërblim dhe dalim prapë tek ajo mbështetja që bashkia duhet ti japi sportit. Por që ta çosh ASHPR-në ndërkohë që ka fshatra që nuk aksesohen dot me rrugë dhe duhet të shkohet me kafshë. Që të mbjell një tapet bari vetëm këtu tek juve ndodh. Ironi fati më të madhe se kjo, ku fëmijët e shikojnë futbollin nga televizori dhe skanë terrene dhe as rrugë për të shkuar në shkollë, e në vend ti bësh rrugët këtyre po të mbjellësh tapet bari, ju qofshi.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ka qenë ky Këshill Bashkiak që e ka kaluar të gjithë pjesën e puntorisë nga ndërmarrja për terrenet sportive, ku ka qenë në fakt nga Agjensia e Sporteve e kemi kaluar tek Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale që në vitin që kaloi dhe është po e njëjta strukturë që merret dhe do merret me të njëjtën gjë. Pra struktura që merret tek sporti I vjetër sot do të merret edhe me stadiumin. Po ta lexosh edhe materialin është shumë e qartë kjo gjë që janë kapacitetet njerëzore që janë tek sporti I vjetër të cilët do të merren edhe ato me mirmbajtjen e stadiumit dhe nuk ka lidhje fare pjesa brigadat dhe funksionimi I brendshëm I Ndërmarrjes së Punëve Publike Rurale. Ndërmarrja e Punëve Publike Rurale është e ndarë në 2 drejtori, Drejtoria e Shkumbinit Sipër dhe Shkumbinit Poshtë, dhe ky është një sektor I cili merret me këtë pjesë, me terrenet sportive të sportit të vjetër ose Shefqet Lamçes dhe po me të njëjtën strukturë do merret edhe me stadiumin.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Kishit gjë tjetër? Hapet votimi.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, 3 kundër, 7 abstenim, miraton sa më sipër.

(A.Kana; E.Murataj; E.Muzhaqi)

(Y.Balliu; D.Çepa; B.Çopja; A.Domni; E.Isaj; M.Kaçuli; A.Meçja)


Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7. Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Z.K 8521, Partisë Socialiste dega Elbasan nga Bashkia Elbasan.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 3 kundër, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

(Y. Balliu; A. Kana; A. Marku)

(B. Çopja; M. Kaçuli; A. Meçja)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 8 e rendit të ditës

8. Për miratimin e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë për vitin 2026.

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ky projekt vendim bazohet në ligjin 139/2015 për vetqeverisjen vendore dhe në ligjin 22/2018 për strehimin social dhe VKM përkatëse nr 362 datë 29.05.2019. Me qëllim që të krijohet mundësia për strehim të përshtatshëm e të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim që me të ardhurat e tyre nuk e përballojnë pagesën e qerasë në treg duhet që me vendim të Këshillit Bashkiak të miratohet vlera maksimale e subvencionit. Grupi I punës I Bashkisë ka testuar tregun dhe nga informacionet e marra nga agjensitë imobilare kanë dhënë informacionin për çmimet e referencës dhe konkludojnë që qeratë mesatare të apartamenteve për efekt subvencionimi do të jenë :gazoniere 10.000 lekë/muaj, apartament 1+1 10.000 lekë/muaj, apartament 2+1 12.000 lekë/muaj dhe apartament 3+1 15.000 lekë/muaj. Kërkohet miratimi në këshill për këto grup njerëzish që kanë të nevojshme të përballojnë qeranë e banesës nga ana e shtetit.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqë e kam ngritur shumë herë shqetësimin për mbështetjen e shtresave në nevojë dhe qëndrimi im është që duhen mbështetur të gjithë, pa përjashtim dhe pa vendosur shtesa specifike. Kisha një pyetje për kryetarin, nga eksperiencia që kemi, të paktën unë kam 2 vjet që e kalojmë këtë në këshill dhe realisht sa familje kanë përfituar dhe sa familje janë skualifikuar dhe për çfarë motivesh janë skualifikuar? Në mënyrë që të kuptojmë që me këtë mbështetje që jep bashkia, sa përfitojnë realisht qytetarët sepse ne vetëm letra shofim këtu, nuk është se realisht

çfarë ndodh në terren I marrim vesh të gjitha.Sepse edhe tek materiali që na ka ardhur thjesht vijnë si numra, dhe siç tha edhe kolegu Z.Bullari me çmimet e referenës së tregut në agjensitë imobilare kuptojmë sesa mundet dhe duhet të jetë mbështetja financiare që jep bashkia.Por unë e kam problemin tek dokumentacioni, a kemi hasur probleme këto vite për mosplotësim dokumentacioni për shkak të kriterëve shumë kërkuese të bashkisë dhe ndoshta këtë vit nuk mund të bëhet gjë më shumë në mënyrë që në vitet e tjera t'ju lehtësojmë familjeve të cilat janë nevojtare për të marrë këtë mbështetje.Dhe nëse ka diçka që mund të bëjmë për lehtësimin e kriterëve atëherë si këshill të mblidhemi dhe të ndryshojmë ato çfarë mund të ndryshojmë apo të çojmë një kërkese në qeveri që të ndryshojnë kriteret ligjore sepse ndoshta mund të na digjen fonde.Na janë djegur fonde në vitin e kaluar për mbështetjen e ktyre apo e morën të gjithë familjet të cilat aplikuan dhe ishte diçka që nuk pati problematikë përse I përket dokumentacionit?

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Faleminderit që më dhatë mundësinë që të bëj një apelim për qytetarët sepse është data 03 nëntor dita e fundit e aplikimeve për bonusin e qerasë.E kemi thënë që në momentin që u hap në këtë mbledhje të këshillit bashkiak, kur u hap skema e bonusit të qerasë.Është një nga skemat që I vjen në ndihmë qytetarëve në nevojë, grave të dhunuara, grave të divorcuara, atyre që janë në vështirësi ekonomike, shtresave të ndryshme vulnerabël, si edhe familjeve që për një arsye apo për një tjetër I është prishur banesa e tyre e cila mund të ketë qënë e pa legalizuar dhe ka ngelur pa mundësi akomodimi në një banesë të vetën.Dua ti bëj apel të gjithë familjeve, të gjithë atyre që duan të përfitojnë nga kjo skemë të aplikojnë deri në datë 03 nëntor është e hapur dhe është një moment I mirë që I vjen në ndihmë familjeve që janë në nevojë.Qeratë ashtu siç po I miratoni ju janë ato me vlerë tregu pra është mesatarja e vlerës së tregut për garzoniere 10.000 lekë/muaj, për apartament 1+1 10.000 lekë /muaj ,për apartamente 2+1 12.000 lekë/muaj, dhe apartamente 3+1 15.000 lekë/muaj.Kto janë çmimet të cilat po miratoni sot, për mbështetjen e familjeve në nevojë për bonusin e qerasë .Deri tani kemi afër 200 aplikime dhe 200 dosje të cilat po bëhen gati dhe me plotësimin e dokumentacioneve që janë në vazhdimësi të familjeve të cilat janë në nevojë dhe kanë aplikuar në këtë skemë.Vitin që kaloi ashtu siç e keni informacionin Z.Kana se e keni miratuar në këshill vjet edhe keni qënë vetë prezent kur e keni miratuar dhe kanë qënë 309 familje të cilat janë kualifikuar për plotësimin e

dokumentacionit. Dokumentacioni është I qartë, kërkesat ligjore janë të qarta. Familjet në nevojë që nuk kanë një banesë të tyre, kanë vështirësi ekonomike për të përballuar një qera në tregun e lirë dhe nuk I kanë ato të ardhura por janë me shumë fëmijë apo janë në skema të tjera sociale ashtu siç mund të futen gratë e dhunuara, ato që janë me urdhër mbrojtje, shtresat në nevojë janë të lutur që të aplikojnë. Vit pas viti janë miratuar të gjithë ato që kanë aplikuar. Do ju lutesha shumë të gjithë qytetarëve të cilët kanë interes të aplikojnë edhe këtë vit pasi skema ka volum, janë gati 315 kuota të lira në mos gaboj, vitin që kaloi kemi patur 309 aplikime, kemi bërë edhe nga bashkia për raste të ndryshme specifike kemi patur një mbështetje gjatë vitit por do të vazhdojmë edhe këtë vit. Ajo që është e rëndësishme është që ne sot të miratojmë këtë vlerë tregu në mënyrë që të merret si çmim reference. Kur mbyllet aplikimet, miratohet edhe përfituesi sipas kriterëve ligjore të tyre dhe dokumentacionit përkatës që sjellin në Bashkinë e Elbasanit që merren në shqyrtim, kemi dhe vlerën e përcaktuar të mbështetjes financiare.

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në vazhdimin e replikës përsa I përket sqarimit e kemi bërë dhe vjet këtë diskutim madje mbaj mend që edhe u propozua të lehtësoheshin sepse ishin më shumë para që I ofroheshin dhe aplikantët ishin më pak. U diskutua që të lehtësoheshin kriteret në mënyrë që mos digjesh fondi dhe kjo I bën nder bashkisë dhe çdo kujt prej nesh. Mbështetja e njerëzve të pamundur, qëllimi I bashkisë dhe qeverisë sepse këto janë vendimarrës dhe bëjnë ligjet. Përgjithsisht në frymën e tyre këtë kanë për qëllim të mbështesin të pamundurin, I forti nuk ka nevojë shumë për mbështetje, po të dobtit kanë nevojën më immediate për mbështetje ligjërisht. Do të sygjeroja diçka tjetër që në faqen tuaj të bashkisë të jeni pak më aktivë në këtë çështje që të informoni qytetarët për afatet, për kriteret, në mënyrë që ata që kanë qenë të painformuar dhe nuk përfituan dot vitin tjetër të jenë më të vëmendshëm dhe ata të cilët kanë afatin deri në dt 3 nëntor të përshpejtojnë dhe I bëjnë thirrje të gjithë qytetarëve të aplikojnë dhe bashkia të jetë më aktive me pjesën e faqes sociale për këtë çështje.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Edhe unë jam plotësisht dakort por vetëm pa u shkelur ligjet. Hapet votimi.

Këshilli Bashkiak me 40 vota pro,1 kundër, - abstënim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 9 e rendit të ditës

9. Për miratimin e përdorimit të një pjese të fondit të Emergjencave Civile dhe kalimin e tij Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale.

Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Bashkia Elbasan ka lidhur një marrëveshje me repartin 4040 të Ministrisë së Mbrojtjes që të kryejë operacione xheniere për 3 urat në Bashkinë e Elbasanit në të cilat 2 janë në fshatin Për Sollak NJ.A Papër dhe 1 është në Polis NJ.A Shushicë. Në bazë të marrëveshjes është ngarkuar ASHPR-ja për planin e vitit 2025 nuk është parashikuar buxhet për këtë agjensi prandaj kërkohet me domosdo që të shtohet financiarisht buxheti në ASHPR që të zbatohet projekti dhe urat janë tepër të domosdoshme sepse shërbejnë për kalimin e këmbësorve, fëmijëve nëpër shkollë, banorëve, prodhimeve bujqësore e blegtorale pra është një domosdoshmëri kalimi i këtij fondi sepse urat janë bërë nga Bashkia, këmbët e urave dhe kanë mbetur vetëm mbulesa e cila do të kryhet nga ky repart ushtarak. Investimi është tepër emergjent. Janë parashikuar këto zëra shtesë lëndë drusore 576.000, vida

217.800, naftë 178.000, vajra lubrifikantë 52.800 dhe dieta për 26 specialistë për 22 ditë 1.100.000 .Çmimet janë referuar çmimet që ka botuar Instati, studimi I tregut, çmimi I kontratave të mëparshme I karburantit që kemi ne si bashki ndërsa për dietat është vendimi I qeverisë 997 për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë shtetit me dietat përkatëse. Janë të argumentuara të gjitha sëbashku dhe bëjnë 2.324.600 lekë të cilat do ti paksohen fondit të emergjencës civile dhe do ti shtohet fondit të ASHPR-së. Jnë investime të domosdoshme të cilat përfitojnë komunitetet që e kanë patur pothuajse ëndërr kto urat, në shekuj kan kaluar në ujë, besoj që është e domosdoshme ky miratim fondi për ti ardhur në ndihmë banorëve të këtyre fshatrave.

Këshilli Bashkiak me 36 vota pro, 1 kundër, 4 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Muzhaqi)

(Y.Balliu; A.Kana; A.Marku; A.Meçja)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 10 e rendit të ditës

10. Për një shtesë në VKB nr.16 datë 29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjetet motorrike në administrim të ASHPR”

Shefqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqenëse ne si këshill në fund të vitit 2024 kemi miratuar normativat për çdo administrator 50 litra në muaj karburant, dhe meqenëse 8 administratorë janë zëvendësuar të Njësive Administrative dhe kanë ndryshuar dhe lloji I mjetit dhe targa e mjeteve, është e domosdoshme të miratohet në këshill po kjo normë karburanti për secalin administrator të cilët e kanë të nevojshme lëvizjen e mjeteve brenda territorit të njësive për kontrollin e territorit, për shërbime publike pra bëjnë goxha lëvizje dhe është e domosdoshme ti caktojmë këtë normë karburanti. bëhet vetëm për efekt të ndryshimit të llojit të mjetit dhe targave përkatëse.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Për fat të mirë ose për fat të keq se varet si e interpretojnë këtë, kryetari I komisionit na sqaroi që qenkan vetëm 50 litra mirëpo në procedurën bashkëlidhur që mesa duket janë kujdesur ta bëjnë në këtë rast, kemi disa procesverbale për disa mjete me targa që skanë rëndësi të kujt janë. Nga 3 përfaqësues ku procesverbali në pamje të parë duket shumë korrekt, vetëm se bien ë sy që bëjnë dhe normativën e këtyre mjeteve, gjq që kam përshtypjen se përveç 50 litërshit kur kanë punë që duhet të bëjnë e duhet të lëvizin përdoret për ti subvencionuar këto administrator. Në kërkesën që të kam bërë te grupi I Këshillit Bashkiak për një raportim nga një institucion I bashkisë për çështjen e naftës, se kam bërë kot. por fatmirsisht unë I besoj kryeministrit të vendit sidomos kur e ka seriozisht pjesën e intiligjencës

artificiale dhe sot bazuar dëshirën që kam për ti besuar Kryeministrit të vendit tim, ju referova Diellës dhe chatgpt për 2 mjete që ju këtu I keni bërë normizim le të themi, normimin e karburantit sa konsumon. Më del që një Ford Focus harxhoka 06-1 litër/orë karburant. Dhe në kilometra sikur të jetë bërë gabim kjo këtu ishte 5 litra/100 km. Vazhdojmë me një mjet tjetër Porsche Cayenne, nuk e di se si mund të normohet një mjet që kushton 30.000 euro e një administrator që merr 70.000-80.000 lekë pagë dhe një Ford Focus konsumoka 8 l/orë, një Porsche Cayenne shumë më të madh kubature harxhoka 10 l. Diella dhe chatgpt rrëzojnë pjesën e atyre që kanë bërë këtë raportin tuaj

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Çfarë konkluzioni ke? Me temën që ne po diskutojmë..

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Ta them unë konkluzionin, ose normimi që bëhet këtu bëhet për të abuzuar me karburantin

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Edhe një herë të gjithë administratorët e njësive kanë nga 50 litra, ky është me vendim këshilli dhe në rastin konkret kjo ka ardhur për arsye se janë ndryshuar..

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Pytja ime është pse është bërë normimi? Meqë kanë vetëm 50 litra, normimi pse është bërë? Në rast se ti do justifikosh litrat nuk duhet të marrin të gjithë në mënyrë të barabartë.

Përfaqësues I ASHPR

Si fillim të falenderojë për këtë gabim që është bërë, është një lapsus mes orëve dhe km, ndjesë është faji im. Pjesa e normimit 50 litra janë caktuar nga këshilli. Ne sido të jetë normativa aty nuk ka vend për abuzim sepse janë caktuar 50 litra. Normimi bëhet sepse do justifikohen lëvizjet ku e harxhoi këtë karburant dhe ky është problem pastaj, do ti japi 50 litra karburant dhe mbaroi këtu apo ai do caktojë ca detyra funksionale që do justifikojë këtë naftë. Çështja është këtu ti si do të thotë administratori që unë isha në Godolesh dhe harxhova 50 litra karburant? Ai do

justifikojë detyrat që ka bërë në terren. E dyta dalim tek Diella, nëse e pyete për karburantin ato janë normative që dalin nga fabrika.

Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Është shumë mirë që këtyre administratorëve po i bëhet një nder i madh sepse mua spo më duket fare i madh që po marrin nga 50 litra sepse deri dje nuk kanë pas marrë dhe të paktën ata 4-5 herë në muaj duhet të vijnë të paraqiten në bashki se bëjnë mbledhje. Pra nuk duhet të vihet në diskutim pse i marrim këto 50 litra. Unë do të thoja që kta që janë pak më larg si labinoti mal që është një terren shumë i thyer që 50 litra i duhen vetëm për shkuar përshembull. Graceni, Funari që janë shumë malore duhet ti shtohet pak, mbi 50 litra. Ky ishte propozim.

Eugen Isaj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kjo është qesharake, 50 litra administratorët? Më mirë mos e kishit sjellë fare, nëse ne do të dëbatojmë edhe për 50 litra karburant që marrin administratorët e Bradasheshit, Shirgjanit, është kot ajo punë. Administratorët të paktën të kenë 200 litra të vijnë për qark. 50 litra për një në labinot mal është shumë pak, ai të paktën 6-7 herë do vijë në muaj këtu.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Sot është sjellë sepse janë ndryshuar administratorët. Ne e miratojmë çdo vit në fillim të vitit kur miratohet buxheti miratohet edhe kjo normativë për administratorët. Ka disa vitë që i është miratuar dhe vazhdon çdo muaj ato marrin për shërbimet që bëjnë brenda Njesisë Administrative për problematikat që ka fshati, për problematikat që kanë fshatrat e tjerë dhe duhet të dalin nga qendra e njesisë. Për ti qendruar pranë problemve që ka njësia, të mos konsumojnë lekët e rrogës. Brenda njesisë nuk mund të quhet që është me shërbim apo nga njësia administrative për të ardhur në qytet në bazë të kilometrave. Kështu që kemi vendosur para disa vitesh që të rimbursohet një 50 litërsh karburant në muaj. Është e vërtetë që Njësitë Administrative të cilat janë larg sidomos zonave malore Zavalina, Graceni, Funari, Gjinari, Labinoti Mal kanë të gjitha problematika. Tregani dhe ka fshatra deri afër Gramshit që kanë një konsum më të lartë dhe për të qenë më afër komunitetit patjetër që e kemi menduar këtë rimburim. Mund të bëjmë një rishikim vitin tjetër, e kemi të miratuar këtë si zë për buxhetin e këtij viti, është thjesht ndryshimi i targave për shkak të ndryshimit të

administratorëve. Kjo është këtë herë, nuk është një çështje që do diskutojmë do japim 50 apo do japim 200 litra. Do bëjmë një normativë për vitin tjetër, tani është thjesht ndryshimi i targave. Administratori i Nj. A Funar ka qenë një person tjetër me një targë tjetër dhe tani është ndërruar administratori i Nj. A Funar dhe ndryshohet dhe numri i targës dhe personi pra administratori. Vitin tjetër shohim mundësinë që atyre që janë më larg ti bëjmë një normativë më të madhe të shpenzimit të karburantit. Ky është qëllimi i këtij akti.

Hektor Çiftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pa diskutim e miratoj këtë vendim, do doja që në buxhetin e ardhshëm, llogjika ime prej këshilltari të vjetër e do që makinat që përdorin administratorët të jenë makina të bashkisë dhe jo personale. Mund të mbahet shënim për tu futur në buxhetin e ardhshëm.

Artan Kana-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Edhe unë mendoj që u zgjatëm pak më shumë se çduhej e do flas shkurt. Është e vërtetë që administratorëve sa më larg të jenë aq më shumë nevojë i lind për karburant. Është e vërtetë që ne i kemi miratuar këto kuota pra 50 litrat. Si opozitë në mënyrë të veçantë na bie për detyrë që kur të shohim shpenzimet buxhetore vitin tjetër apo programin buxhetor që do bëj bashkia për vitin tjetër, të jemi shumë më të vëmendshëm sepse marshallah paskemi administratorë me Porsh apo Audi Q7 në ndryshim nga njëri që na paska ik me Toyota Yaris, duhet ta mbështesim pak më shumë këtë me Toyota se duket që është më me siklet.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapim votimin

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro, 1 kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E. Murataj)

(A. Kana; A. Murati)

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.10.2025, ora 14:14 në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e Kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Znj. Enerieta Ferra, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të ndryshme:

1-Për miratimin e projektit Menaxhimi I Integruar I rasteve (ICM) për punëkërkuesit e cënueshëm, duke mbështetur rrugët e tyre nga ndihma sociale në punësim.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ke diçka për këtë pikën?

Dritan Çepa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Jo për këtë pikën, unë kam një shqetësim të përsëritur dhe këtë e kam me Kryetarin e Bashkisë, për gjendjen e rrugëve në Elbasan. Në çfarë stadi është kontrata me nënkontraktorin e Ndërmarrjes së Ujësjellësit? A ka mbaruar si afat kontrate dhe nëse jo kur mbaron? A ka një drejtori Bashkia që monitoron gjendjen e rrugëve sepse happen në mënyrë të papërgjegjshme dhe të pa lajmëruar, të përsëritur, ndryshohen senset e rrugëve, bllokohen në sens unik. Gjendja në akse specifike e rrugëve është katastrofale. Tani që ka filluar dhe shiu dhe në mëngjes kur prindërit çojnë fëmijët në shkollë, është katastrofë. Ju Kryetar besoj e dini mirë sepse edhe zona rreth shtëpisë tuaj ditët e fundit sidomos është bërë katraurë. Do doja që të na informoni për gjendjen dhe përgjegjësinë që mban Bashkia për rehabilitimin e këtyre rrugëve. Faleminderit!

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Ashtu siç e dini I nderuar, ne kemi bërë një interpelancë me kompaninë dhe Ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime kompani zbatuese. Leja vazhdon, I mbaron në fillim të dhjetorit dhe po 2 javëshin e parë të dhjetorit I mbaron edhe leja e ndërtimit. Ne I kemi dhënë lejen e ndërtimit, me atë jemi përgjegjës dhe leja e

ndërtimit në bazë të planit të grafikut që ato kanë pra që ka fituar edhe procedurat kompania, në bazë të tyre ecën me ujësjellësin. Supervizori është supervizori I nënkontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizimeve dhe nga KFV-ja Gjermane. Pra e kanë një supervisor të huaj që I supervizon për afatet e punimeve dhe për cilësinë e punimeve. Ndërkohë ndërmarrja jonë ose Drejtoria jonë e Shërbimeve në Bashkinë e Elbasanit I monitoron në vazhdimësi dhe mban në kontroll të vazhdueshëm pjesën e problematikave. Ka patur problematika të vazhdueshme kryesisht të lidhura më ripërsëritjen e një shqetësimi që dhe unë e kam patur të vazhdueshëm, me rihapjen e të njëjtave nyjeku bëhet lidhja e vazhdueshme e tubave kryesorë. Janë shtruar paraprakisht tubat tek lagjet psh tek ambulanca, tek lagjia jonë pikërisht aty është bërë lidhja e të gjithë investimit që u bë. Do mbahet në kontroll pasi dhe ato vetë kanë sensor që I vendosin, kanë sisteme të ndryshme. kanë filluar më një pjesë të rrugëve edhe aty ku kishin problematikë që duhej ti bënë me sondë sidomos te rruga e vjetër që shkon për tek Kryqëzimi I Cerrikut afër markatës, edhe aty kanë vazhduar dhe po vazhdojnë me pjesën e sistemit dhe asfaltimit. Kanë ngelur patjetër për pjesën e lidhjes. Në shumë banesa kanë ngelur për lidhjen fundore, në shumë zona kanë ngelur që të mbyllet I gjithë cikli. Nuk mund të mbyllet I gjithë cikli sipas ekspertëve që I kemi patur edhe në mbedhjen e këshillit, pa u bërë lidhja kryesore. Është akoma duke u punuar, është më mirë seç ka qënë. Gjatë periudhës së verës patëm një ngarkesë shumë të madhe pasi u punua paralelisht në shumë fronte, tashmë gjendja po vjen duke u stabilizuar. Nuk di të ketë patur kërkesë, nuk kam ndonjë informacion përse I përket kërkesës për zgjatje të lejes së ndërtimit.

Dritan Çepa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Edhe diçka të fundit për subjektet që marrin leje nga Bashkia Elbasan, leje ndërtimi që kanë edhe aksesin me lidhjen e kanalizimin e ujerave të zeza. Dëmi që I shkaktohet rrugës është përgjegjësi e bashkisë për rehabilitim pasi klienti paguan taksë. Taksa I kalon bashkisë apo ujësjellësit? Kur merr personi leje ndërtimi paguan dhe një taksë infrastrukturore.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Lejen e ndërtimit për lidhjen e ujësjellësit të kanalizimeve të ujrave të zeza në pjesën më të madhe të rasteve kur janë siç është ujësjellësi I merr ujësjellësi. Dhe rehabilitimin e ka detyrë ujësjellësi.

Dritan Çepa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëherë unë thjesht do kërkoj rritjen e monitorimit nga ana juaj të Ndërmarrjes së Ujësjiellësit për rehabilitimin e këtyre lidhjeve se dhe këto janë shqetësim.

Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan

Patjetër, faleminderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Atëherë këtu është përfaqësuesja e Tjetër Vizion

Diana Kasa-Përfaqësuese e Organizatës Tjetër Vizion

Përshëndetje, unë jam Diana Kasa drejtore programesh pranë Organizatës Tjetër Vizion. Në fakt edhe në dokumentacione që është paraqitur nga stafi I bashkisë në lidhje me projektin në fjalë dhe propozimi që ne kemi për bashkinë, për punësimin e 20 rasteve nëpërmjet një bonus punësimi të cilët përfshihen në projekt që është Menaxhimi I Integruar I Rasteve për punëkërkuesit në nevojë. Dua tju jap një informacion në lidhje me projektin. Është një projekt I financuar nga B.E, I zbatuar nga PNUD-I dhe I realizuar në bashkëpunim me Organizatën Tjetër Vizion në partneritet me Bashkinë e Elbasanit. Qëllimi është që nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit dhe I mbështetur në VKM-në 401 I cili në fakt nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Punësimit synon që organizatat që përfshihen dhe kanë programe të formimit profesional, të nxitjes së punësimit dhe identifikimit të target grupeve në nevojë, ti nxisim dhe ti nxjerrim nga skema e ndihmës ekonomike nëpërmjet një punësimi të qëndrueshëm në tregun e punës. Ajo që synoj brenda këtij projekti është 16 mujor, projekt I cili ka filluar në periudhën Mars 2025-Qershor 2026. Synojmë që të identifikojmë dhe të trajnojmë dhe ndërkohë mbi 100 gra dhe vajza nëpërmjet skemës së ndihmës ekonomike, janë target grupe në nevojë që dalin nga bashkëpunimi që kemi me bashkinë. Nëpërmjet identifikimit cilat janë gratë dhe vajzat, skema e ndihmës ekonomike, gra dhe vajza të patrajnuara, të pa edukuara e të pa arsimuara, nëna të vetme, viktima trafikimi, viktima dhune, vajza dhe gra me aftësi të kufizuara. I kemi ndarë në 5 grupime dhe me një total prej 100 grash dhe vajzash. Të gjitha marrin mbas ciklit të këshillimit që quhet cikël këshillimi për punësim, nuk u ndërpritet skema e ndihmës ekonomike ndërkohë që e marrin këtë dhe është e ndarë në 3 faza 6 mujore ku përfshihen 35-40 gra për çdo fazë. Mbasi marrin këtë lloj trajnimit ndërkohë orjentohen edhe për formime profesionale. Një

nga kto duke qenë se e kemi tagrin të ofrojmë edhe kurse profesionale është ofrimi I kursit për ëshërbim psiko-social dhe shëndetsor për moshën e tretë.Me Bashkinë e Elbasanit kemi synuar që të bëjmë dhe një kryqzim tjetër përveç se të përgatisim këtë target për orientim dhe trajnim profesional dhe ti hedhim edhe në tregun e punës për të ofruar edhe një shërbim tjetër që e quajmë shërbim lëvizës për moshën e tretë sidomos atë në nevojë ku ne presim që të identifikohen 50 raste të moshës së tretë që të jenë në nevojë ekstreme ku nëpërmjet një shërbimi lëvizës të ktyre rasteve që trajnohen nga Tjetër Vizioni të kenë mundësi ti ofrojnë shërbim lëvizës në familje këtyre rasteve.Ideja është që në përfundim të këtij projekti të kemi 50 raste të moshës së tretë të ndihmuara nga këto 20 gratë të cilat ne I kemi kërkuar bashkisë që të ndihmohen me bonus punësimi për ktë periudhë gjatë gjithë projektit.Sigurisht është projekt pilot dhe ne synojmë që nëse do jetë I suksesshëm më pas të kalojë në qëndrueshmëri nëpërmjet rishikimit të buxhetit të 2026 për ta parë si një program të vëçantë dhe të dedikuar për moshën e tretë.Ajo që ne I kërkojmë bashkisë është që nëpërmjet fuqizimit të këtyre 20 grave dhe vajzave që dalin nga nskema e 100-ve që ne I trajnojmë, të kenë mundësi të punësohen nëpërmjet një bonus punësimi që bashkia mund ta japi dhe të mbulojnë asistencën ndaj 50 rasteve që po bashkia do ti identifikojë për tu mbështetur nga këto raste.Faleminderit.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Normal që të ndihmojmë shtresat në nevojë është detyrë parësore e gjithë shoqërisë dhe ju falenderoj për kontibutin që I jepni prej shumë vitesh si shoqatë.Normalisht që bashkia ka mekanizmat e saj të ndihmës dhe në momentin që vjen një palë e tretë siç janë shoqatat dhe organizatat e ndryshme kemi detyrimin që ti mbështesim.Në monet që po I bëni kërkesë Këshillit Bashkiak e po kërkonin një fond nga bashkia prej 12 milion lekësh për projektin pilot, keni dhënë disa detaje se si do ti përzgjidhni njerëzit apo çfarë nevojash do të përpiqeni të plotësoni me këtë por ajo që I takon Këshillit Bashkiak të miratojë është ky fond dhe nuk keni dhënë asnjë lloj sqarimi se si do zbërthehet ky fond për personat pra sa do shkojë tek trajnimi, sa do shkojnë tek një lloj mbështetje tjetër, sa do shkojnë tek një lloj shpenzimi tjetër.Nuk I keni bërë bashkisë apo këshillit një zbërthim të kësaj natyre, ne mund ta miratojmë po pa e ditur se ku po shkojnë lekët me detaje siç e dëshiron ligji dhe siç kemi detyrim ti themi qytetarëve tanë që I dhamë lekët për njerëzit në

nevojë por duke na qënë e qartë që shkuan kaq për këtë detyrë kaq për këtë detyrën tjetër.

Diana Kasa-Përfaqësuese e Organizatës Tjetër Vizion

Faleminderit shumë për pyetjen, unë mund të përgjigjem vetëm për faktin që në identifikimin që I bëjmë 20 rasteve dhe aktualisht ne kemi nxjerrë kontigjentin e parë prej 15 rastesh nga të cilat 7 pretendojmë që bashkia ti punësojë sepse normalisht jo të 15-ta e kanë vlerësimin tonë që mundet ta ofrojnë një asistencë të tillë dhe do jenë 7 në këtë fazë. Pra në këtë 6 mujor të parë që ne e mbaruam Mars-Shtator, më pas një shtatshë tjetër dhe në fund fare një gjashtëshe pra në përfundim të ciklit 16 mujor. Ideja është që çdo muaj kto zonja të cilat do ofrojnë një shërbim dmth 1 zonjë do ti përgjigjet 3 rasteve të moshës së tretë dhe do marri.. për mua është një bonus shumë modest 10.000 lekë të reja në muaj pra nuk quhet pagesë quhet bonus. Këtë besoj se bashkia mund ta japë më shumë, unë jam.....

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë jam I qartë dhe thjesht po them në detyrën e këshilltarit më duhet të di kto lekët do shkojnë kaq për subvencion këtu, kaq për trajnim aty. Keni dhe trajnimet e kuptoj, këtë kam unë për detyrë sot, si mision e keni në rregull, përzdhjen e njerëzve e keni në rregull, unë dua të di ku do I çoni kto lekët sa dhe pse. Sma keni dhënë në relacion, ju a bashkia nuk e di kush

Diana Kasa-Përfaqësuese e Organizatës Tjetër Vizion

Ne si organizatë në marrëveshjen që kemi realizuar me Bashkinë e Elbasanit I kemi kërkuar në projekt që në fillimet e veta para se projekti të dërgohet tek donatori që të mbështeten 20 gra dhe vajza të cilat dalin nga kjo skemë nëpërmjet një bonusi të tillë që unë e përmenda 10.000 lekë të reja I cili në total është 1.200.000 lekë të reja që janë të dedikuar vetëm për bonus. Ndërsa pjesa e incentivës që ato marrin gjatë kohës së trajnimit është tjetër gjë dhe I përket KNUD-it nëpërmjet mbështetjes që I jep gjatë kohës së trajnimit. Bashkia ka detyrimin në thonjza, në rast se ju e aprovon, që të mbështesë këto gra dhe vajza në punësim të pjesshëm nëpërmjet këtij bonusi pra ky bonus është I dedikuar vetëm për punësimin që ato do kenë, asgjë më tepër. Trajnimi është tjetër gjë, që ato e kanë kaluar dhe e kanë marrë pjesën e incentivës.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje, kisha edhe unë diçka për të shtuar përsa I përket këtij projekti ashtu siç e relatuat duket goxha mirë dhe më pëlqeu fakti kur thatë që ne do ti trajtojmë ato që ti bëjmë të afta në tregun e punës. Dhe në fakt ky duhet të jetë qëllimi I këtij bonusi që po na kërkoni ta japim ne si bashki e ta miratojmë ne si këshill. Ju sugjeroj që me atë trajnim për këtë target grup njerëzish që ju I keni evidentuar dhe do ti trajtoni ti bëni të qartë që mos e shikojnë këtë mbështetje thjesht si një projekt që po marrim disa para po ta shohin si një mundësi që me këtë pagesë që po I bëhet ato të bëhen të afta për në tregun e punës dhe nesër të jenë të vetmjaftueshme të dalin dhe të mos jenë barrë më për shoqërinë. Sa më shumë njerëz në nevojë të kemi në qytet aq barrë të madhe kemi pastaj për ti paguar në ndihmë sociale dhe në shumë shërbime të tjera që ofron bashkia dhe shteti. Ju përgëzoj për këtë nismë dhe për këtë shoqatë që keni por qëllimi të jetë që kjo periudhë tranzitore të shërbejë që ato thjesht të aftësohen, mentaliteti dihet që shumë njerëz thjesht e shohin si një mundësi për të kapur ndonjë pagesë dhe e bëjnë atë punën sa për të kaluar. Të trajnohen mirë dhe të dalin të afta dhe mos jenë barrë për shoqërinë.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Një pyetje kam unë, sa për sqarim më tepër. E vetmja gjë që më ra në sy mua ishte një projekt shumë I madh 14.600.000 lekë të reja dhe kjo kërcet kur vjen me urgjencë. Pa dyshim që nuk ka ndonjë pikpyetje që qëllimi është I mirë. Ju thatë që janë 20 vajza dhe gra në total për tu punësuar dhe këto përfshihen tek ky projekt apo jo? Për këto 20 është ky projekti?

Diana Kasa-Përfaqësuese e Organizatës Tjetër Vizion

20 vajza dhe gra janë të dala nga kontigjenti i 100 vajza dhe grave të cilat janë të trajnuara. Në këtë rast unë për 20 I kërkoj bashkisë të më mbështesë.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Që ta vazhdoj llogjikën dhe mesa kuptova ishte për një afat 16 mujor dhe këto grad he vajza do përfitonin 10.000 lekë të reja shpërblim mujor sipas palëve që do të vijjnë, njëra 6 muaj tjetra 6 muaj tjetra 4 muaj. Unë parimisht jam pro që të jem I qartë por ashtu siç tha edhe kolegu tjetër duhet një pasqyrë që këto lekët ...pavarsisht se bashkia ka një pjesë fare të vogël. Çfarë pasqyre finnaciare ka si projekt? Ku hyn bashkia, ku del në këtë pjesë?

Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Desha ta falenderoj Vizion Plusin për këtë inisiativë të mrekullueshme dhe të gjitha organizatat jo qeveritare duhet të punojnë në këtë drejtim. Shtresa më e persekutuar është moshë e tretë, qoftë nga pensionet, qoftë edhe nga trajtimi që i bëhet. Ka shumë të moshës së tretë që nuk kanë asnjë përkujdesje nga familja sepse janë jashtë shtetit ose janë në punë. Është një shtresë që ka më shumë nevojë sesa kjo që po bëhet me vision plusin. 12 milion lekë që kërkohen është një gjë minimale dhe as nuk duhet ta vem në diskutim për moshën e tretë dhe shpresoj që kjo që do bëhen të afta të jenë në gjendje që të punojnë në shërbim të moshës së tretë me një pagë më të madhe sepse ka familje që janë në gjendje fëmijët ta paguajnë por nuk njerëz të aftë sepse që edhe ta mbash një të sëmure të moshës së tretë do një profesionalizëm jo të vogël pavarësisht nga pagesa. Prandaj unë propozoj që ta votojmë dhe I urojmë vision plusit që në këtë inisiativë të jetë akoma më i fuqishëm, të marrim fonde të tjera në këtë drejtim veçanërisht për moshën e tretë. Faleminderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapim votimin

Këshilli Bashkiak me 35 vota pro,- kundër, 2 abstenim, miraton sa më sipër.

(E.Murataj;E.Muzhaqi)

Faleminderit të gjithëve!

Mbledhja përfundon në orën 15:26

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Hatixhe Kotherja

